



**ELSIG**

NJE HAP PËRPARA  
ONE STEP FORWARD

KOMPANIA E SIGURIMEVE SH.A.

INSURANCE COMPANY J.S.C.

info contact:  
Tel: 038 221-112

info fax:  
Fax: 038 221-115

info cell:  
Mob: +377 44 220715

info e-mail:  
kselsig.prishtine@gmail.com

Prishtinë, Kosovë  
10000

KOMPANIA E SIGURIMEVE 'ELSIG »SH.A. PRISHTINE

***K U S H T E T  
E PERGJITHSHME PËR SIGURIM TE PËRGJEGJËSISË  
Publike/Pofesionale NGA VEPRIMTARIA***

**Prishtinë, Gusht 2008.**

Në bazë të nenit 76 pika 11. të Statutit të kompanisë së sigurimeve “ Elsig “ sh.a. Bordi i drejtorëve i Kompanisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur në Gusht 2008. miratoi Kushtet e pergjithshme për sigurimin e pergjegjesisë Publike/Profesionale nga veprimtaria.

## I. DISPOZITA HYRËSE

### Zbatimi i Kushteve të sigurimit

#### Neni 1

Këto Kushte aplikohen për sigurimin e përgjegjësive ngaj veprimtaria Publike/Profesionale dhe nëse përgjegjësia sigurohet në ndonjë lloj tjetër sigurimi, këto Kushte aplikohen nëse kushtet për këtë lloj sigurimi e parashikojnë këtë.

### Kuptimi i shprehjeve të veçanta

#### Neni 2

Shprehjet e veçanta të përdorura në këto Kushte kanë këto kuptime:

1. “sigurues” – shoqëri aksionare për sigurim me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit,
2. “kontraktuesi i sigurimit” – personi që me siguruesin lidh kontratën e sigurimit,
3. “i siguruar” – personi, përgjegjësia e të cilit mbulohet me sigurim,
4. “personi i tretë” – personi i cili nuk është subjekt i kontratës për sigurim, gjegjësisht personi përgjegjësia e të cilit nuk është e kontraktuar,
5. “shuma e sigurimit” – detyrimi maksimal i siguruesit për rastin e siguruar,
6. “premi” – shuma që paguhet për sigurim sipas kontratës së sigurimit,
7. “polica” – kontrata për sigurimin e përfunduar,
8. “fletëmbulesa” – kontrata e lidhur për sigurim që zëvendëson përkohësisht policën,
9. “rast i siguruar” – është rasti që mund të ndodh në afatin kohor të sigurimit, i cili si pasojë e ndodhjes së tij i shkaktohet dëm material dhe jo material palës së tretë, dëmi është shkaktuar pa qëllim, pa dashje dhe papritmasë nga vullneti i të siguarit.
10. “burim i rrezikut” – veprimtaria (profesioni) e sendeve (të luajtshme dhe të paluajtshme), raporti i vërtetë ose vetia e caktuar nga të cilat mund të krijohet përgjegjësia si rrezik i mbuluar me këtë sigurim.

## II. DISPOZITA THEMELORE

### Objekti i sigurimit

#### Neni 3

- (1) Objekt i sigurimit sipas këtyre Kushteve është përgjegjësia ligjore e të siguruarit për dëmin e shkaktuar, për shkak të vdekjes, lëndimit të trupit ose shëndetit, përkatësisht dëmtimit ose zhdukjes së sendeve të personit të tretë.
- (2) Me këtë sigurim mbulohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në qoftë se është bërë ose nga veprimtaria profesionale e të siguruarit, ose nga zotërimi i sendeve, ose nga raporti juridik, ose nga vetia e caktuar si burim i rreziqeve që janë shënuar në policën e sigurimit, përkatësisht në ofertë.
- (3) Me sigurim gjithashtu mbulohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga:
  1. rritja e rrezikut të siguruar ose zgjerimi i burimit të rrezikut që është shënuar në policë gjatë kohës së sigurimit;
  2. burimi i ri i rrezikut që paraqitet te i siguruari pas lidhjes së kontratës së sigurimit në vështrim të nenit 5 të këtyre Kushteve (sigurimi nga burimet e reja të rrezikut).
- (4) Përgjegjësia e kontraktuar nuk është e mbuluar me sigurim, përveç nëse kjo është parashikuar me këto kushte ose me kushte plotësuese ose është kontraktuar në mënyrë të veçantë.
- (5) Nëse kjo është parashikuar në dispozitat plotësuese të këtyre Kushteve, ose nëse është kontraktuar në mënyrë të posaçme, sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë për:
  1. dëmet për shkak të vjedhjes ose humbjes së sendeve;
  2. dëmet që nuk janë shkaktuar as nga lëndimi i personit as nga dëmtimi përkatësisht zhdukja e sendeve të ashtuquajtura dëm “i pastër” pasuror.

### Zgjerimi i sigurimit

#### Neni 4

- (1) Në kuadër të burimit të siguruar të rrezikut të veprimtarisë është përfshirë edhe përgjegjësia e të siguruarit nga:
  1. shfrytëzimi, përkatësisht zotërimi, qiradhënia ose përfitimi i fryteve: të tokës, ndërtesave dhe lokaleve që shfrytëzohen ekskluzivisht për nevojat e veprimtarisë ose të profesionit të siguruar;
  2. shfrytëzimi i objekteve të standardit shoqëror, që u shërbejnë ekskluzivisht punëtorëve të të siguruarit (si p.sh. restorantet e ushqimit shoqëror, banjat, pushimoret, fushat sportive etj);
  3. përdorimi i ashensorëve të udhëtimit dhe të bartjes;
  4. përdorimi i biçikletave zyrtare për nevoja të veprimtarisë së siguruar;
  5. magazinimi i materialit për zjarr dhe për vënie në lëvizje për përdorim ekskluziv në ushtrimin e veprimtarisë ose profesionit të siguruar;
  6. për shkak të vjedhjes ose humbjes së sendeve të përdorimit personal të punëtorëve të të siguruarit, përveç: të hollave, fotoapararit, sendeve me vlerë të të gjitha llojeve, letrave me vlerë dhe dokumenteve të të gjitha llojeve, me kusht që sendet të jenë vendosur në lokale të mbyllura ose në kthina të mbyllura;
  7. mbajtja dhe përdorimi i makinave punuese jovetëlëvizëse dhe i mjeteve transportuese jovetëlëvizëse për nevojat e veprimtarisë së siguruar;
  8. shfrytëzimi i makinave punuese vetëlëvizëse dhe i mjeteve transportuese vetëlëvizëse kur nuk janë në funksion të automjeteve motorike (të ashtuquajtura “rrezik pune”);
  9. mbajtja dhe shfrytëzimi i kafshëve tërheqëse, me kusht që ky burim rreziku të kontraktohet posaçërisht tek shpeditërit dhe transportuesit sipas profesionit.
- (2) Kur është fjala për objektet e përmendura në paragrafin (1) pika 1 dhe 2 të këtij neni, sigurimi përfshin edhe përgjegjësinë:
  1. e të siguruarit si investitor ose kryes i punimeve ndërtimore (ndërtim i ri, meremetim, riparim, gëlqerosje, mihje etj.) kontraktimi i sigurimit mund të bëhet në shumën minimale të sigurimit prej

30,000.00 €, për një rast të siguruar me mundësi të zgjidhjes së shumave të sigurimit edhe më të mëdha, duke shfrytëzuar pjesëmarrje në dëme dhe lirime në premi.

- nga zotërimi i garazheve që gjenden në pasurinë e paluajtshme të siguruar, kur nuk i referohet garazhit që shfrytëzohet për ushtrimin e veprimtarisë ose për garazh hoteli.

### **Sigurimi nga burimet e reja të rrezikut**

#### Neni 5

- (1) Nëse kontrata e sigurimit është lidhur me pagesën e premisë së sigurimit tërësisht ose pjesërisht, në bazë të fitimeve mesatare neto të punëtorëve ose të hyrave të përgjithshme mbulesa nga sigurimi zgjerohet edhe për përgjegjësinë nga burimet e reja të rrezikut që paraqiten tek i siguruari pas lidhjes së kontratës së sigurimit në qoftë se për këtë burim të ri rreziku nuk është përfunduar një sigurim i veçantë.
- (2) Obligimi i siguresit për kompensim nga sigurimi fillon menjëherë me të paraqitur të burimit të ri të rrezikut. I siguruari ka për detyrë që në fund të periudhës së sigurimit, me rastin e përcaktimit të shumës përfundimtare të premisë, të paraqesë të gjitha burimet e reja të rrezikut.
- (3) Nuk krijohet obligimi i siguresit për kompensim nga sigurimi në rast të paraqitjes së burimit të ri të rrezikut, nëse siguresi sipas kushteve të sigurimit dhe tarifës së premive nuk siguron një burim të tillë rreziku.
- (4) Për burimet e reja të rrezikut vlen shuma e sigurimit që është në policën e sigurimit të siguruar për burimet e mëhershme të siguruara të rrezikut. Nëse polica, për burime të veçanta rreziku, përmban shuma të ndryshme sigurimi, do të vlejë shuma e sigurimit për burimet e rreziqeve të cilat premia llogaritet në bazë të fitimit neto ose të hyrave të përgjithshme nga veprimtaria. Nëse ekzistojnë disa shuma të ndryshme të sigurimit për të cilat premia llogaritet në këtë mënyrë, si e kontraktuar do të vlejë shuma më e madhe e sigurimit.
- (5) Sigurimi i burimeve të reja të rrezikut nuk mbulon përgjegjësinë nga:
  1. mbajtja ose përdorimi i hekurudhës, teatrit, kinemasë, cirkut, tribunave si edhe xhirimit të filmave;
  2. mbajtja dhe përdorimi i planerëve, automjeteve në ujë dhe automjeteve motorike;
  3. punimi, përpunimi, vendosja, transporti, përdorimi dhe tregtimi i materialit eksploziv, përveç në rastet kur për këtë ekziston leja e organit kompetent;
  4. gjuetia si veprimtari dhe si sport gjahu.

### **Vëllimi i mbulesës për dëmet për shkak të ndotjes së tokës dhe ujit**

#### Neni 6

- (1) Me ndotje të tokës dhe të ujit kuptohet ndryshimi i vetive të natyrshme biologjike, kimike ose fizike të tokës ose ujit për shkak të emisionit të materieve të dëmshme që mund të shkaktojnë ndryshime të tilla.
- (2) Sigurimi përfshin vetëm dëmet për shkak të lëndimit të trupit ose shëndetit të ndonjë personi që janë pasojë e ndotjes.
- (3) Nëse kontrahohen posaçërisht dëmet për shkak të zhdukjes ose dëmtimit të sendeve, janë të mbuluara me sigurim nëse janë shkaktuar nga prishjet e paparashikuara me ndonjë stabiliment ose për shkak të zjarrit apo shpërthimit. Përgjegjësia për dëme për shkak të ngjarjes së papritur dhe të befashme është përfshirë në sigurim edhe atëherë kur vetë dëmet janë shkaktuar gradualisht.
- (4) Përgjegjësia për dëme lidhur me rritjen e burimit të rrezikut të shënuar në policë për shkak të përparimit ose ndryshimit të prodhimit nuk është përfshirë në sigurim, përveç në rastet kur kjo kontrahohet posaçërisht.
- (5) I siguruari merr pjesë në çdo rast të siguruar 10%, minimum 1,000.00 € .

- (6) Nga sigurimi është përjashtuar përgjegjësia për dëmet që do të ndodhin për shkak se i siguruari nuk i ka mirëmbajtur dhe riparuar instalimet për pastrimin e ujrave të zeza dhe produkteve të tjera të hedhura, as nuk iu ka përmbytur masave të tjera të parashikuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit jetësor të njeriut.

### **Sigurimi nga përgjegjësia për dëme “të pastra” pasurore**

#### Neni 7

- (1) Nëse kontraktohet në mënyrë të posaçme (neni 3, paragrafi (5) pika 2 ose kur kjo është parashikuar me dispozitat plotësuese të këtyre Kushteve, sigurimi mbulon përgjegjësinë për dëme “të pastra” pasurore, d.m.th. dëmet që nuk janë shkaktuar as nga lëndimi i trupit apo shëndetit të ndonjë personi, as nga dëmtimi apo zhdukja e sendeve.
- (2) Konsiderohet se rasti i siguruar është krijuar atëherë kur është kryer veprimi, përkatësisht nuk është kryer veprimi i duhur gjatë ushtrimit në policën e veprimtarisë së shënuar, posedimit të ndonjë sendi etj. (burim i rrezikut) me të cilin i është shkaktuar dëm “i pastër” pasuror ndonjë personi.
- (3) Sigurimi përfshin përgjegjësinë për dëme, shkak i të cilave (veprimi ose mosveprimi) është krijuar gjatë kohës së sigurimit.
- (4) Nëse dëmi është bërë për shkak të mosveprimit konsiderohet, në rast dyshimi, se mosveprimi ka ndodhur atë ditë kur veprimi i pakryer është dashur të ndërmerret për të shmangur dëmin.
- (5) Sigurimi përfshin veprimet, përkatësisht mosveprimet në Kosovë, pasojat e të cilave poashtu kanë lindur në Kosovë.
- (6) Nga sigurimi janë përjashtuar dëmet:
1. për shkak të tejkalimit të parallogarisë dhe kredive sipas kontratave për blerje dhe shitje e sidomos për shkak të mospërmbushjes së afateve të kontraktuara të liferimit dhe obligimeve të garantuara;
  2. për shkak të ndërmjetësimit në punë financiare dhe në punë të tjera ekonomike;
  3. të krijuara për shkak të deficitit në arkë, gabimeve gjatë pagesave dhe shpërdorimit nga ana e punëtorit të të siguarit;
  4. për shkak të taksimit të padrejtë dhe të metave të tjera për sa i përket ngarkimit me taksa;
  5. të shkaktuar me faktin që i siguruari nuk e ka vërejtur gabimin në llogari, parallogari ose në masa në vizatime;
  6. për shkak të humbjes së sendeve.
- (7) Obligimi i të siguarit, sipas dispozitave të këtij neni, është i kufizuar në 25 % të shumës së sigurimit që është parashikuar për rastin e siguruar nga shuma për dëmtimin e sendeve, përkatësisht shuma e përbashkët e sigurimit, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.

### **Përjashtimi nga sigurimi**

#### Neni 8

- (1) Sigurimi nuk përfshin:
1. përgjegjësinë e të siguarit për dëmin e shkaktuar qëllimisht, përveç nëse dëmin e ka shkaktuar qëllimisht punëtori i të siguarit, në të cilin rast siguruari hyn në të drejta të të siguarit ndaj punëtorit si person përgjegjës;
  2. përgjegjësinë për dëmet e lidhura drejtpërdrejt me përdorimin e materieve radioaktive, përveç përgjegjësisë për radioizotope që shfrytëzohen për qëllime paqësore në mjekësi etj.
  3. përgjegjësinë për dëmet nga mbajtja ose përdorimi i automjeteve motorike që i nënshtrohen sigurimit të detyrueshëm, planerëve, automjeteve në ujë;
  4. dëmet që i pësojnë i siguruari, bashkëshorti/ja i/e të siguarit, fëmijët dhe personat e tjerë që jetojnë me ta në bashkësi familjare e cila e ka për detyrë t'i mbajë;

5. përgjegjisinë e të siguarit në bazë të zgjerimit të kontraktuar të përgjegjësisë së tij edhe për rastet me të cilat përgjigjet;
  6. dëmet në sende ose në punë të kryera të cilat i siguruari ose ndonjë person tjetër sipas urdhrin të tij ose për llogari të tij i ka punuar ose liferuar, në qoftë se shkak i dëmit qëndron në punimin ose liferimin e sendeve;
  7. dëmet nga produktet me të meta;
  8. dëmet në sendet e huaja të shkaktuara nga i siguruari në këto ose me këto sende të veprimtarisë nga profesioni (si p.sh. përpunimi, riparimi, transporti, ekzaminimi etj.), përveç nëse dëmi është shkaktuar nga ngjarja që nuk është e lidhur drejtpërdrejt me gabime profesionale të të siguarit;
  9. dëmet që janë bërë si pasojë e veprimit të vetëdijshëm në kundërshtim me dispozitat ose rregullat sipas të cilave ushtrohet veprimtaria apo profesioni si burim rreziku nga polica.
  10. dëmet që janë pasojë e ndotjes së ajrit;
  11. dëmet që janë pasojë e sëmundjeve profesionale të punëtorëve të të siguarit;
- (2) Me sigurim nuk janë mbuluar dëmet që bëhen në sende për shkak të:
1. ndikimit të vazhdueshëm të temperaturës, gazeve, avullit, lagështisë ose të reshurave (tymit, blazës, pluhurit etj.), si edhe për shkak të mykut, tronditjes, pyjeve etj. që ka për pasojë shkaktimin gradual të dëmit;
  2. uljes së truallit ose rrëshqitjes së dheut;
  3. vërshimeve nga ujërat amull, rrjedhëse dhe nëntokësore.
- (3) Nëse kontraktohet posaçërisht, sigurimi përfshin përgjegjësinë për dëmin:
1. për shkak të pjesëmarrjes në gara hipizmi, gara çiklike, motoçiklike dhe automobilistike, në meçe boksi dhe mundjeje, si dhe pjesëmarrjes në përgatitjet për gara të përmendura;
  2. në sendet e huaja të cilat kontraktuesi i sigurimit i ka marrë me qira, për hua-përdorje, hua, për t'i ruajtur, transngarkim etj.

### **Vlefshmëria territoriale e sigurimit**

#### Neni 9

Në sigurim janë përfshirë rastet e siguruara që kanë ndodhur në territorin e Kosovës, kurse në territorin e vendeve të tjera vetëm atëherë kur kjo kontraktohet posaçërisht ose kur është parashikuar me dispozita plotësuese.

### **Rasti i siguar**

#### Neni 10

- (1) Konsiderohet se rasti i siguar ka lindur në atë moment kur ngjarja e dëmshme, në bazë të së cilës do të mund të lindte kërkesa për kompensim nga sigurimi kundër të siguarit, ka filluar së vepruari.
- (2) Disa ngjarje të dëmshme që kanë ndodhur nga i njëjti shkak ose nga shkaqe të njëjtoja që janë të lidhura me termin kohor konsiderohen si një rast i siguar.

### **Vlefshmëria kohore e sigurimit**

#### Neni 11

- (1) Siguruesi hyn në detyrim vetëm atëherë kur rasti i siguar ndodh në kohën e vlefshmërisë së sigurimit.
- (2) Rasti i siguar që ka lindur gjatë kohës së sigurimit të vlefshëm, shkak i të cilit rrjedh nga periudha pararendëse e lidhjes së kontratës së sigurimit ose nga koha kur është ndërprerë sigurimi, është i mbuluar me sigurim vetëm nëse kontraktuesi i sigurimit ose i siguruari deri në fillimin e sigurimit

apo rifillimin e sigurimit nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë shkakun nga i cili rrjedh rasti i siguruar.

- (3) Nga dëmet për shkak të dëmtimeve të shëndetit që ndodhin gradualisht, në rast dyshimi, konsiderohet se ngjarja e dëmshme ka ndodhur atëherë kur për të parën herë nga mjeku është konstatuar dëmtimi i shëndetit.

### **Shuma e sigurimit**

#### Neni 12

- (1) Shuma e sigurimit është detyrim maksimal i sigurvearit.
- (2) Shuma e sigurimit është e ndryshueshme dhe përcaktohet në vlera absolute në atë mënyrë që numri i fitimeve mesatare të paguara neto të shumës së kontraktuar shumëzohet me shumën e fitimit neto mesatar të paguar në muaj që vlen në ditën e likuidimit të dëmit.

Me fitim neto mesatar të paguar kuptohet fitimi neto mesatar i paguar sipas të dhënave statistikore të shpallura zyrtarisht për punëtor në Kosovë për periudhën e mëparshme përlllogaritëse.

- (3) Zbrazja e shumës së sigurimit nga paragrafi i mësipërm realizohet kur shuma e kompensimit të jetë e barabartë me shumën e përcaktuar në ditën e likuidimit të dëmit te pagesat e njëhershme, ose kur shuma e pagesave të shprehura në % të shumës së sigurimit të përcaktuar në vështrim të paragrafit të mësipërm të arrijë 100%.

### **Detyrimet e të sigurvearit pas krijimit të rastit të sigurvearit**

#### Neni 13

- (1) I sigurveari ka për detyrë të njoftojë të sigurvearin për krijimin e rastit të sigurvearit, si edhe për kërkesën e paraqitur për dëmshpërblim jo më vonë se 3 ditë pas njoftimit.
- (2) I sigurveari ka për detyrë të informojë sigurvearin edhe atëherë kur kërkesa për dëmshpërblim kundër tij të jetë paraqitur nëpërmjet gjykatës, kur të jetë nën arrest si edhe kur të ketë filluar procedura për sigurimin e provave.
- (3) Nëse ka filluar hetimi, është ngritur padia ose është marrë vendimi për procedurë penale, i sigurveari ka për detyrë që ta njoftojë menjëherë sigurvearin, qoftë edhe atëherë kur ta ketë paraqitur ngjarjen e dëmshme që ka ndodhur. Gjithashtu është i detyruar të dërgojë konstatimin e organit kompetent lidhur me ngjarjen e dëmshme që ka ndodhur.
- (4) Nëse me sigurim është mbuluar rreziku i vjedhjes së sendeve, i sigurveari është i detyruar që menjëherë ta paraqesë vjedhjen tek organi i sigurimit publik.
- (5) I sigurveari nuk është i autorizuar që pa pëlqimin paraprak të sigurvearit të deklarojë rreth kërkesës për kompensimin e dëmit, e sidomos ta pranojë plotësisht ose pjesërisht, as ta bëjë barazimin në kompensim apo pagesën në kërkesën e dëmshpërblimit, përveç nëse sipas gjendjes së fakteve nuk ka pasur mundësi të refuzojë akceptimin, kompensimin – pajtimin ose pagesën e që me këtë të mos bëjë një padrejtësi flagrante. Në qoftë se i sigurveari në lajthim ka konsideruar se ekziston përgjegjësia e tij ose se janë vërtetuar drejt faktet, kjo nuk e justifikon.
- (6) Nëse nuk arrihet marrëveshja për kompensim nga sigurimi me procedurë jashtëgjyqësore, e si rrjedhim i dëmtuari bën padi kundër të sigurvearit në procedurën kontestimore ose procedura kontestimore hapet në bazë të vendimit të gjyqit në procedurën penale për dëmin, i sigurveari ka për detyrë t'i dërgojë sigurvearit letërthirjen gjyqësore përkatësisht padinë dhe të gjitha shkrirat lidhur me ngjarjen e dëmshme dhe kërkesën për kompensimin e dëmit, si edhe zhvillimin e kontestit t'ia lërë në dorë sigurvearit.
- (7) Nëse i sigurveari kundërshton propozimin e sigurvearit që kërkesa për kompensimin e dëmit të zgjidhet me pajtim, sigurveari nuk është i detyruar të paguajë tepricën e kompensimit, kamatat dhe shpenzimet e krijuara nga ky shkak.
- (8) Në rast se i dëmtuari i drejtohet drejtpërdrejt me kërkesë për kompensim të dëmit sigurvearit, i sigurveari është i detyruar që sigurvearit t'ia ofrojë të gjitha provat dhe të dhënat që i ka në dorë dhe



që janë të domosdoshme për përcaktimin e përgjegjësisë për dëmin e bërë dhe për vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës si dhe lartsisë së dëmit.

- (9) Nëse i siguruari për shkak të rrethanave të ndryshuara fiton të drejtën që t'i hiqet ose t'i pakësohet renta personit të dëmtuar, ka për detyrë që ta njoftojë për këtë siguruesin.
- (10) Nëse i siguruari nuk i përmbahet detyrimit nga ky nen, do të heqë pasojat e dëmshme që lindin nga kjo, përveç atëherë kur ato do të krijoheshin edhe sikur t'i përmbahej obligimit.

### **Detyrimi i siguresit pas krijimit të rastit të siguar**

#### Neni 14

Pas krijimit të rastit të siguar siguruasi është i detyruar:

1. të ndërmarrë, bashkë me të siguarin, mbrojtjen nga kërkesat e pambështetura ose të tepruara për kompensimin e dëmit ( mbrojtja juridike neni 15);
2. të plotësojë kërkesat e bazuara për kompensim nga sigurimi (kompensimi nga sigurimi neni 16);
3. të kompensojë shpenzimet e procedurës gjyqësore (kompensimi i shpenzimeve neni 17).

### **Mbrojtja juridike**

#### Neni 15

- (1) Obligimi i siguresit për mbrojtjen juridike përfshin:
  1. shqyrtimin e përgjegjësisë së të siguarit për dëmin e bërë;
  2. zhvillimin e kontestit në emër të të siguarit nëse i dëmtuari realizon të drejtën e dëmshpërblimit në procedurën kontestimore;
  3. dhënien e të gjitha deklaratave në emër të të siguarit, të cilat i konsideron të arsyeshme për satisfaksion ose mbrojtje nga kërkesa e pabazuar ose e tepruar për dëmshpërblim.
- (2) Me pëlqimin dhe sipas udhëzimit të siguresit, zhvillimi i kontestit mund t'i besohet të siguarit, i cili në rastin e tillë ka për detyrë t'u përmbahet udhëzimit dhe urdhrit të siguresit në lidhje me procedurën kontestimore.
- (3) Siguruasi mund të marrë përsipër zhvillimin e procesit ndërgjyqës ose të paraqitet në vend të të siguarit apo të marrë pjesë me cilësinë e personave të implikuar.
- (4) Siguruasi është i autorizuar të refuzojë zhvillimin e kontestit ose t'ia lërë atë të siguarit nëse vlerëson se nuk ka vend për ofrimin e mbrojtjes juridike duke pasur parasysh masën e dëmshpërblimit të kërkuar dhe shumën e sigurimit.
- (5) Në rastë se siguruasi në emër të kompensimit nga sigurimi paguan shumën e sigurimit para fillimit të kontestit pushon së qeni edhe obligimi i tij për mbrojtje juridike.

### **Kompensimi nga sigurimi**

#### Neni 16

- (1) Siguruasi është i detyruar që brenda 10 ditësh të paguajë kompensimin e sigurimit duke llogaritur nga dita kur është përcaktuar obligimi dhe lartësia e këtij obligimi.
- (2) Siguruasi është i autorizuar që në emër të kompensimit t'ia depozitojë të siguarit shumën e sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve të ngarkuara në vështrim të dispozitave të nenit 17 të këtyre Kushteve, me ç'rast lirohet nga të gjitha pagesat dhe procedurat e mëtejshme në lidhje me dëmin.
- (3) Në depozitim për sigurimin e kompensimit të dëmit për të cilin i siguruari është i detyruar në bazë të dispozitave ligjore ose vendimit gjyqësor, siguruasi merr pjesë me të njëjtën masë, si edhe në kompensimin nga sigurimi.

- (4) Nëse i siguruari është i detyruar të paguajë në emër të dëmshpërblimit një rentë, e vlera e kapitalizuar e rentës kalon shumën e sigurimit, ose shuma që mbetet pasi të hiqen pagesat e tjera lidhur me rastin e njëjtë të siguruar, renta borxh do të kompensohet vetëm në përpjesëtim midis shumës së sigurimit përkatësisht shumës së mbetur të sigurimit dhe vlerës së kapitalizuar të rentës.
- (5) Nëse siguruari kundërshton propozimin e të siguruarit që kërkesa e kompensimit nga sigurimi të barazohet, ka për detyrë të paguajë kompensimin, kamatat dhe shpenzimet edhe atëherë kur këto e kalojnë shumën e sigurimit.

### **Kompensimi i shpenzimeve**

#### Neni 17

- (1) Siguruari kompenzon të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore nëse vetë e ka zhvilluar kontestin ose ia ka dhënë pëlqimin të siguruarit për zhvillimin e kontestit, madje edhe atëherë kur kërkesa për dëmshpërblim nuk ka qenë e bazuar
- (2) Nëse kontesti është bërë pa dijen dhe pa pëlqimin e siguruarit, me sigurim mbulohen shpenzimet e kontestit vetëm brenda caqeve të shumës së sigurimit me kusht që kontesti të jetë i bazuar dhe shpenzimet të arsyeshme.
- (3) Siguruari paguan shpenzimet e avokatit në procedurën penale kundër të siguruarit për shkak të ngjarjes që do të mund të kishte si pasojë paraqitjen e kërkesës për kompensim nga sigurimi në bazë të përgjegjësisë së mbuluar me sigurim vetëm në rastet e veçanta nëse është i njohur me deponimin e avokatit dhe nëse ka pranuar të përballojë shpenzimet. Shpenzimet e procedurës penale, si edhe shpenzimet e përfaqësimit të palës së dëmtuar, siguruari nuk i kompenzon.
- (4) Pasi ta kryejë obligimin e vet me pagesën e shumës së sigurimit dhe pjesës përkatëse të shpenzimeve, siguruari lirohet nga pagesat e tjera të mëtejshme në emër të kompensimit të shpenzimeve të një rasti të siguruar.

### **Zbatimi i Kushteve të përgjithshme për sigurimin e pasurisë**

#### Neni 18

Për sigurimet e përfunduara sipas këtyre Kushteve zbatohen Kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë, përveç dispozitave që janë rregulluar ndryshe me këto Kushte.

## **III.DISPOZITA PLOTËSUESE PËR BURIME TË VEÇANTA TË RREZIKUT**

### **Zbatimi i dispozitave plotësuese**

#### Neni 19

Për sigurimin nga përgjegjësia prej burimeve të veçanta të rrezikut, krahas dispozitave themelore të këtyre Kushteve, aplikohen edhe dispozitat plotësuese nga kjo pjesë e Kushteve në lidhje me vëllimin e mbulesave.

### **Avokatët, ndërmjetsuesit në punët e sigurimeve dhe të risigurimeve**

#### Neni 20

- (1) Me sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia për dëme "të pastra" pasurore lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së avoketëve, ndërmjetsuesve (neni 7 i këtyre Kushteve).
- (2) Te sigurimi i bashkësive të avoketëve, ndërmjetsuesve ose zyrave të përbashkëta apo zyrave regjionale të disa avoketëve, ndërmjetsuesve, me sigurim mbulohen vetëm ato dëme që i shkakton avokati, ndërmjetsuesi i cili ka lidhur kontratën e sigurimit.
- (3) Nga sigurimi është përjashtuar përgjegjësia e avokatit, ndërmjetsuesit për dëmet që i shkakton me cilësinë e zëvendësit të avokatit, ndërmjetsuesit tjetër.

### **Autoserviset, punëtoritë automekanike etj.**

#### Neni 21

- (1) Në sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia për dëmet e zotërimit të vendeve për vendosjen e automjeteve motorike, si edhe nga shitja e materialit të nevojshëm për lëvizjen e automjeteve (benzinë, vaj etj.).
- (2) Nëse kontraktohet në mënyrë të veçantë, në sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia për dëmet e shkaktuara:
  1. gjatë riparimit të automjeteve,
  2. nga vjedhja e automjetit,
  3. nga përdorimi i palejuar nga ana e punëtorit të të siguarit dhe nga ana e personave të tjerë.

### **Spitalet, qendra mjekuese-klimaterike, sanatoriumet, dispanseritë, ambulancat etj.**

#### Neni 22

- (1) Në sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia për dëmet nga humbja ose vjedhja e sendeve për përdorim pers) onal të pacientëve dhe të shoqëruesve të tyre, nëse këto sende janë dorëzuar për t'u ruajtur.
- (2) Përgjegjësia për dëme për shkak të humbjes ose vjedhjes së të hollave, letrave me vlerë, sahatave, dokumenteve, stolive dhe sendeve të tjera të çmuara është përfshirë në sigurim e vetëm në rast se këto sende i janë dorëzuar për t'i ruajtur të siguarit dhe nëse i siguruari i mban në një arkë të kyçur.
- (3) Me sigurim nuk është mbuluar përgjegjësia e të siguarit për shkak të dëmeve në automjete të të sëmurëve dhe të shoqëruesve të tyre, as në pjesët përbërëse të këtyre automjeteve, as të sendeve mbi ose brenda automjeteve.

### **Garderoba**

#### Neni 23

- (1) Me sigurim është mbuluar edhe përgjegjësia e të siguarit për shkak të dëmtimit, zhdukjes, humbjes ose vjedhjes (apo ndërrimit) të sendeve të dorëzuara në garderobë për t'u ruajtur me vërtetimin përkatës (numri, blloku etj.).
- (2) Nga sigurimi është përjashtuar përgjegjësia e të siguarit për dëmet nga humbja ose vjedhja e të hollave, letrave me vlerë, sendeve të çmuara, sahatave dhe dokumenteve të çdo lloji, si edhe të gjitha sendeve të lëna në xhepat e palltos apo sendeve të tjera të veshjes që janë dorëzuar për t'u ruajtur në garderobë.
- (3) Siguruesi ka obligim vetëm atëherë kur garderoba ka rojë të përhershme dhe kur në të, pos rojës, nuk mund të hyjnë persona të tjerë.

### **Veprimtaria e ndërtimit, montimit dhe veprimtari të tjera të ngjashme**

#### Neni 24

- (1) Në sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia për dëmet nga nivelimi i terrenit që e bën i siguruari nëse nivelimi u referohet punimeve që duhet t'i kryejë i siguruari, me ç'rast përjashtohet nga sigurimi përgjegjësia për dëmet në objekt, për ndërtimin e të cilit bëhet nivelimi.
- (2) Në sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia për dëmet:
  1. të shkaktuara drejtpërdrejt nga dëmtimi i instalimeve nëntokësore (si linja:për gaz, ujë, rymë, kanalizim etj) nëse nuk është kontraktuar veçmas që të përfshihen edhe dëmet indirekte;
  2. të shkaktuara nga minimi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së të siguarit, por jo edhe dëmet në sendet që gjatë minimumit ndodhen më pak se 75 metra larg nga pika e minimumit, po qe se nuk është kontraktuar ndryshe.
- (3) Nga sigurimi është përjashtuar përgjegjësia për dëmet:

1. në ndërtimet fqinje për shkak të moskryerjes së përforcimit të duhur (me shtylla etj);
  2. në objektin që ndërtohet ose montohet, të cilin i siguruari e ndërton ose në të cilin punon;
  3. të shkaktuara nga rrënimet në sendet të paluajtshme që gjenden në rreth, rrezja e të cilit i përgjigjet lartësisë së objektit që rrënohet;
  4. nëse janë siguruar një pjesë e objektit ndërtimor ose punime të veçanta ndërtimore e zejtare, sigurimi nga përgjegjësia i kryesve të punimeve ndërtimore nuk i mbulon dëmet në pjesë të tjera të këtij objekti ndërtimor ose në punimet e tjera ndërtimore e zejtare që nuk janë siguruar, përkatësisht që janë siguruar me një policë tjetër.
  5. nëse është siguruar një pjesë e objektit montazh ose punime të veçanta montimi, sigurimi nga përgjegjësia e kryesve të punimeve të montimit nuk mbulon dëmet në pjesë të tjera të këtij objekti montazhi ose punimet e tjera montuese që nuk janë siguruar, përkatësisht që janë siguruar me një policë tjetër.
- (4) I siguruari merr pjesë në çdo rast sigurimi 10%, minimum 1,000.00 € .

### **Banjat** Neni 25

- (1) Me sigurim është mbuluar edhe përgjegjësia e të siguarit për humbjen dhe vjedhjen e sendeve të përdorimit personal të mysafirëve në banja, nëse këto sende kanë qenë të mbyllura në kabina ose lokale të tjera përkatëse për vendosjen e sendeve ose kur i janë dorëzuar të siguarit për t'i ruajtur.
- (2) Përgjegjësia për dëmet nga humbja dhe vjedhja e parasë, letrave me vlerë, sendeve të çmueshme, sahatave, dokumenteve etj. është mbuluar me sigurim vetëm atëherë kur këto sende i janë dorëzuar të siguarit për t'i ruajtur dhe nëse mbahen në arkë të kyçur.
- (3) Me sigurim është mbuluar edhe përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga sendet e të siguarit që shërbejnë për sport, rekreacion dhe argëtim të mysafirëve të banjave.
- (4) Me sigurim nuk është mbuluar përgjegjësia e të siguarit për dëmet në automjete në ujë dhe në tokë, në pjesët përbërëse të tyre, si edhe as në sendet që gjenden jashtë automjetit ose brenda tij.

### **Mjekët** Neni 26

- (1) Në sigurim janë përfshirë edhe dëmet e “pastërta” pasurore (neni 7 i këtyre Kushteve).
- (2) Me sigurim mbulohet përgjegjësia edhe për dëmet e shkaktuara gjatë dhënies së ndihmës urgjente mjekësore në territorin e Kosovës.

### **Limanet dhe depot publike** Neni 27

- (1) Nëse kontraktohet në mënyrë të veçantë, në sigurim është përfshirë përgjegjësia:
  1. për dëmet e shkaktuara në mall të huaj gjatë:
    - magazinimit,
    - palimit dhe përforcimit,
    - matjes, numërimit, ndarjes në klasa, markimit,
    - paketimit dhe ndreqjes së paketimit,
    - transportimit dhe mbartjes në lokalim afarist;
  2. për dëmet nga ndotja e detit, bregdetit dhe objekteve të tjera;
  3. për dëme “të pastërta” pasurore.
- (2) Në sigurim nuk është përfshirë përgjegjësia:
  1. për dëme të shkaktuara nga:
    - tërheqja, lundrimi, ruajtja dhe mbrojtja e anijeve,
    - lidhja, zgjidhja dhe shpëtimi i anijeve,
    - transporti i personave me barka lundruese dhe lidhëse,
    - finalizimi, përpunimi, riparimi etj,
    - egalizimi, fumigimi, pastrimi, gëlqerosja, tharja etj.

- shpeditimi ndërkombëtar dhe intern i mallit,
  - magazinimi dhe ruajtja e mallit në frigoriferë;
2. për dëme indirekte (p.sh. humbja e tregut, rënia e çmimeve, ndalimi i importit ose eksportit).
- (3) Në çdo dëm i siguruari merr pjesë 10%, minimum 1,000.00 €, përveç rasteve kur është kontraktuar ndryshe.

### **Veprimtaria bujqësore dhe pyjore**

#### Neni 28

- (1) Me sigurim është mbuluar edhe përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga
1. mbajtja e kafshëve, por jo edhe dëmet që u bëhen shtazëve kur lëshohen ose gjatë mbarsjes artificiale, përveç kur kjo është kontraktuar veçmas;
  2. shfrytëzimi i mjeteve në tokën e të siguarit për heqjen e barojës si dhe pengimin e luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve me kusht që, përveç kur kontraktohet ndryshe, i siguruari në çdo rast sigurimi të marrë pjesë 20% , minimum 2,000.00 €;
  3. ndërmarrja e punimeve ndërtimore në tokën e të siguarit nëse vlera parallogaritëse e këtyre punimeve nuk është më e madhe se 30,000.00 €;
- (2) Në sigurim është përfshirë edhe përgjegjësia e të siguarit me cilësinë e personit privat në vështrim të nenit 32 të këtyre Kushteve.

### **Binarë lidhës, teleferikët, depot hekurudhore me qiramarrje, vinçat dhe makineritë për ngarkim – shkarkim**

#### Neni 29

- (1) Nëse veprimtaria e të siguarit si burim i rrezikut nga polica e sigurimit ushtrohet me shfrytëzimin e binarëve lidhës shtesë, teleferikëve, depove hekurudhore me qiramarrje, vinçave dhe makinerive për ngakrim-shkarkim sigurimi përfshin edhe:
1. përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i binarëve lidhës (pyjorë, fushorë, industrialë) dhe teleferikëve, nëse transporti bëhet pa arkëtuar taksën.
  2. përgjegjësia për dëmet nga përdorimi i vinçave dhe i makinerive për ngarkim dhe shkarkim nëse nuk janë shkaktuar gjatë përdorimit të makinerive të cilat sipas konstruksionit e lëshojnë barrën të bjerë poshtë;
  3. përgjegjësia e kontraktuar për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i depos hekurudhore me qiramarrje sipas hekurudhës Kosovare.
- (2) Nëse kontraktohet posaçërisht sigurimi mbulon:
1. përgjegjësinë për dëmet nga shfrytëzimi i vinçave dhe i makinerive për shkak të dëmtimit të vagonëve, anijeve, automjeteve motorike nga vinçat dhe makineritë e ngarkim-shkarkimit.,
  2. përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i binarëve ndërlidhës (pyjorë, fushorë, industrialë) dhe teleferikëve nëse transporti bëhet me arkëtimin e taksës.

### **Personi privat – përgjegjësia me këtë cilësi**

#### Neni 30

- (1) Sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguarit për dëmet që i shkakton:
1. me cilësinë e personit privat në jetën e përditshme jashtë ushtrimit të një profesioni ose zanati;
  2. si pronar, shfrytëzues ose qiramarrës i banesës apo të shtëpisë më vete për banim, koopshtit të vogël dhe oborrit;
  3. si punëdhënës ndaj personit në punë në shtëpi;
  4. nga ndërmjetësimi ose përdorimi i biçikletës pa motor;

5. nga ushtrimi i sportit, përveç sportit me të cilin merret profesionalisht si dhe sportit që është i lidhur me përdorimin e automjetit motorik të çfarëdo lloji, sportit me planerë, gjuetisë dhe sporteve të tjera si boksi, mundja, xhudo, karate etj;
6. si mbajtës i kafshëve të buta që nuk shfrytëzohen për veprimtari ekonomike;
7. me armë të ftohtë ose armë zjarri, për mbajtjen e së cilës ka lejen dhe e cila shërben për mbrojtje ose pjesëmarrje në gara të qitjes.

(2) Me të njëjtin vëllim si në paragrafin (1) të këtij neni sigurimi i referohet edhe përgjegjësisë së:

1. bashkëshortit/es së të siguarit dhe fëmijëve që jetojnë me të në bashkësi të përbashkët dhe të cilët është i detyruar të mbajë;
2. personve të punësuar në ekonominë shtëpiake të të siguarit gjatë kryerjes së punëve në të.
- (3) Nëse një pjesë e banesës ose ndërtesës përdoret për ushtrimin e një profesioni, sigurimi nuk përfshin përgjegjësinë nga posedimi i kësaj pjese të banesës apo ndërtesës.
- (4) Nëse kontraktohet posaçërisht përfshihet edhe përgjegjësia për fëmijët e mitur që nuk jetojnë në bashkësinë e përbashkët me të siguarit.

### **Rrugët – mirëmbajtja**

#### Neni 31

- (1) I siguruari në çdo rast mer pjesë 10%, minimum 1,000.00 €, përveç kur me kontratë është përcaktuar ndryshe.

### **Shfaqjet sportive**

#### Neni 32

- (1) Sigurimi përfshin përgjegjësinë e organizatorëve të garave çiklike dhe automobilistike gjatë kohës së garës.
- (2) Nëse gara mbahet në vrapore të hapura, vraporja e tillë duhet të jetë e siguar nga organi i sigurimit publik.

### **Shkollat, institucionet edukativo-arsimore, ruajtja etj.**

#### Neni 33

- (1) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë e të siguarit për dëmet nga humbja dhe vjedhja e sendeve të nxënësve dhe kadetëve vetëm atëherë kur sendet janë të vendosura në lokalet përkatëse.
- (2) Nga sigurimi përjashtohet përgjegjësia për dëmet nga humbja dhe vjedhja e: parave, letrave me vlerë, metaleve të çmueshme, koleksioneve numizmatike, filatelike dhe koleksioneve e sendeve të tjera të çmueshme të të gjitha llojeve.
- (3) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë e:
  1. anëtarëve të këshillave shkollore dhe të këshillave të institucioneve edukuese e të tjera, të cilat sipas dispozitave ligjore dhe akteve të përgjithshme të tyre drejtojnë shkollën ose institucionin;
  2. nga përgaditja e pikniqeve, ekskursioneve, shfaqjeve shkollore etj.

### **Veprimtaria hoteliere**

#### Neni 34

- (1) Me veprimtari hoteliere në vështrim të këtyre Kushteve kuptojmë veprimtarinë që e ushtrojnë: hotelet, kafenetë, restorantet, pansionet, pushimoret, kampet e rregulluara, konviktet studentore – turistike, pansionet e pensionistëve etj.

- (2) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë e të siguarit për shkak të humbjes ose vjedhjes së sendeve të përdorimit personal të mysafirëve, të cilat ata i kanë futur brenda në objektin hotelier. Quhen sende të përdorimit personal edhe: fotoaparati amatorik, pajisjet për uikend dhe pushim, radio aparati dhe televizori, gramafoni me pllaka dhe kasetofoni, dylbia, pushka e gjuetisë, arma personale dhe rekuizitat sportive.
- (3) Sigurimi nuk mbulon përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara në:
1. sendet e mysafirëve gjatë përdorimit, përpunimit ose punës në to nga ana e të siguarit;
  2. automjetin motorik të mysafirëve, pjesët që janë të montuara ose të mbyllura në të, si dhe në sendet e kyçura në automjetin motorik;
  3. për shkak të humbjes ose vjedhjes së sendeve të mysafirëve nëse janë futur brenda në lokalet ku mund të hyjë çdokush, në të cilat serviret ushqimi dhe pijet etj. përveç kur janë dorëzuar në garderobë për t'u ruajtur.
- (4) Nëse nuk kontraktohet në mënyrë të veçantë, sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë e të siguarit për dëmet në automjetin motorik në vështrim të dispozitave të nenit 39 të këtyre Kushteve.
- (5) Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga humbja ose vjedhja e të hollave, stolive, letrave me vlerë dhe dokumenteve të çfarëdo lloji mbulohet me sigurim nëse këto sende i janë dorëzuar të siguarit dhe janë vendosur në arkë të kyçur.
- (6) Sigurimi përfshin edhe përgjegjësinë:
1. nga repartet ndihmëse që i takojnë të siguarit (si kthina për larjen e teshave, kuzhina, furra të bukës, mishtore etj.) që shërbejnë ekskluzivisht për ushtrimin e veprimtarisë së të siguarit;
  2. nga zotërimi i objekteve, lokaleve dhe terreneve për sport dhe argëtim që mysafirët i shfrytëzojnë falas.

### **Kompanit zjarrfikëse**

#### Neni 35

- (1) Sigurimi përfshin përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara gjatë stërvitjeve, aksioneve të shpëtimit dhe të ndihmës.
- (2) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë personale të anëtarëve të kompanisë nga ushtrimi i aktivitetit me cilësinë e zjarrfikësve.
- (3) Sigurimi i referohet edhe përgjegjësisë së kompanisë zjarrfikëse si pronare, qiradhënëse ose shfrytëzuese e tokës, ndërtesave e lokaleve që shërbejnë vetëm për nevojat e kompanisë.
- (4) Nga sigurimi përjashtohet përgjegjësia për dëmet në sende, për shpëtimin e të cilave kompania është e ngarkuar/kompetente.

### **Veterinerët, klinikat dhe stacionet veterinare**

#### Neni 36

- (1) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë e të siguarit për shkak të lëndimit të kafshëve gjatë mjekimit.
- (2) Nëse kontraktohet posaçërisht, sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë për dëmet nga lëndimi i kafshëve gjatë kastrimit, ovariotomisë, trajtimit në gaz dhe mbarsjes artificiale.

### **Automjetet – ruajtja**

#### Neni 37

- (1) Me sigurim mbulohet edhe përgjegjësia e të siguarit për humbjen, vjedhjen dhe ndërrimin e automjeteve që janë lënë për t'i ruajtur (automjete motorike, barka në vend të thatë, rimorkio, motoçikleta dhe biçikleta).

- (2) Nëse automjeti nuk është vendosur në garazhin e kyçur, sigurimi përjashton dëmet në sendet që gjenden mbi ose brenda automjetit, si dhe në pjesë të veçanta të automjetit, përveç sendeve që prodhohen në mënyrë serike me automjetin dhe sendeve që sipas dispozitave duhet të jenë brenda në automjet.
- (3) Siguruesi ka obligim vetëm atëherë kur parkingu i automjeteve është i caktuar dhe shënuar me saktësi dhe kur automjetet janë vendosur dhe siguruar ligjërisht me kusht që të jetë rojtari i përhershëm dhe automjetet të merren për t'u ruajtur me vërtetim. Përgjegjësia për dëmet në barka gjatë stinës së dimrit përfshihet në sigurim vetëm atëherë kur barkat janë vendosur në vendin ku ruhen gjatë dimrit.
- (4) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë për dëmet nga paragrafi (1) i këtij neni në motor të barkave, automjeteve dhe në ndenjëset e lëvizshme me kusht që natën (prej orës 20 deri në orën 07) të mbahen në lokale të mbyllura.

### **Parqet për argëtim, teatrot shëtitës, cirqet etj.**

#### Neni 38

Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë për dëmet që shkaktohen gjatë montimit dhe çmontimit të mjeteve për argëtim.

### **Ndërtesat dhe tokat (zotërimi përkatësisht shfrytëzimi)**

#### Neni 39

- (1) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë për burimet e rrezikut nga neni 4 paragrafi (2) pikat 1 dhe 2 të këtyre Kushteve.
- (2) Sigurimi mbulon përgjegjësinë:
  1. për dëmet që i shkaktojnë personat e autorizuar gjatë drejtimit, pastrimit dhe ndriçimit të ndërtesave, përkatësisht tokës si burim i rrezikut;
  2. për dëmet që i shkaktojnë personat që paraqiten në vend të të siguarit me cilësinë e shfrytëzuesit të ri, përdoruesit të fryteve ose drejtorit falimentues;
  3. për dëmet nga shfrytëzimi i fushave për lojrat e fëmijëve me pajisje përkatëse për argëtimin e fëmijëve, në qoftë se fusha e lojrave i përket ndërtesës si burim rreziku nga policia;
  4. nga zotërimi i kopshtit nëse shfrytëzohet për nevojat e veta dhe nëse i përket ndërtesës ose tokës si burim i rrezikut nga policia e sigurimit.
- (3) Nëse ndërtesa ka më shumë shfrytëzues apo pronarë, siguruesi nuk ka obligim të kompensojë dëmin të cilin ndonjë shfrytëzues ose pronar ia shkakton pronarit tjetër, bashkëshortit-es të tij ose personave që i mban.
- (4) Kërkesat e pronarit përkatësisht shfrytëzuesit të banesës, bashkëshortit/es të tij/saj dhe personave që i mban përfshihen në sigurim nëse nuk marrin pjesë në përgjegjësinë e përbashkët për dëmin me pronarët përkatësisht shfrytëzuesit e tjerë të ndërtesës.

### **Kafshët (mbajtja, rritja dhe tregtia)**

#### Neni 40

- (1) Sigurimi mbulon edhe përgjegjësinë rojtarëve të kafshëve dhe personave të tjerë, që kujdesen për kafshët e shënuara në policën e sigurimit. Përgjegjësia për dëmet nga akti i lëshuarjes mbulohet me sigurim nëse është kontraktuar në mënyrë të veçantë.
- (2) Përgjegjësia nga mbajtja e kafshëve, siç janë: kuajt, mushkat dhe kafshët e tjera tërheqëse, si edhe qeni është e mbuluar me sigurim vetëm nëse është kontraktuar edhe sigurimi i ndonjë burimi tjetër të rrezikut (p.sh. pronat bujqësore, përgjegjësia me cilësinë e personit privat).



Kryetari i Bordit

Agim Elshani

-----